

Emri i Lëndës : Epoka dhe Rrymat Ndërkulturore

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 414	C	2	4	0	0	4.00	6
Lektori dhe orari i konsultimeve			Anxhela Hoxha, PhD				
Asistenti dhe orari i konsultimeve							
Gjuha e kursit			Albanian				
Niveli i lëndës			Master				
Përshkrimi			<p>Kursi i leksioneve me temë "Epoka dhe rryma kulturore" do të përshkruajë, paraqesë dhe interpretojë, rrymat, traditat dhe stilet e mëdha artistike që kanë karakterizuar etapat e ndryshme të qytetërimeve nga antikiteti i thellë deri tek gjendja e sotme e shoqërisë moderne. Në këto leksione do të mbizotërojnë qasja analitike e logjikës kulturore në formësimin e traditave dhe stileve të madha që përbëjnë tiparet e dallueshme të epokave historiko-kulturore. Leksionet do të konceptohen në bazë të frymës dhe përpjekjeve shpirtërore të formacioneve qytetëruese, për të dhënë një përfytyrim mbi shijen e së bukurës, filozofinë, etikën dhe forcën e imagjinatës në përputhje me botëkuptimin adakuat. Gjithashtu do të hetojmë edhe bashkëekzistencën e stileve dhe traditave në sjelljen e një formacioni të ri artistik, mbështetjen dhe shterimin e përvojës së mëparshme në themelimin e traditave të reja. Nga analizat e faktorëve ndikues, do të evidentohen pasionet e thella, relacionet shpirtërore me politikën, luftën, fatkeqësitë, politikën dhe utopitë e ndryshme shoqërore e religjioze. Përgjatë kursit të leksioneve "Epoka dhe rryma kulturore", do të merren në shqyrtim paradigmat më të rëndësishme e më të qëndrueshme të stileve që e kanë karakterizuar qytetërimin në dymijë vjeçarin e fundit. Do të shpjegohet thelbi i dukurisë artistike e kulturore që identifikon epokat kulturore nëpërmjet formësimit të kanonit dhe përpjekja për ta kaluar atë, në të mirë të themelimit dhe formësimit të një kanoni të ri që i zë vendin, duke përfshirë shkaqet dhe thelbin e motivimit për ndryshimin e vetëdijes. Leksionet do të jenë të shoqëruara përpos materialit teorik e interpretativ, edhe me një bazë ilustruese në artet vizuale, muzikës dhe letërsisë. Vend të veçantë do të kenë platformat teorike, traktatet filozofike dhe manifestet artistike që japin kyçin e shpjegimit fenomenologjik të rrymave dhe stileve kulturore.</p>				
Objektivat			<ul style="list-style-type: none"> - Të pajisë studentin me njohuri të plota mbi bazat teorike e ilustrative mbi rrymat dhe stilet e mëdha, duke i bërë lehtësisht të dallueshme tiparet e tyre nga njëri-tjetri, çka nënkupton njohjen e ligjësive të artit dhe shijeve epokale në kontekstin historik. - Të qartësojë studentët mbi faktorët ndikues dhe rolin e madh që ka kultura dhe arti në ndryshimin dhe evolucionin e formacioneve të vetëdijes qytetëruese si reflektim i përvojës së grumbulluar gjatë shekujve. - Të mundësojë studentët për një njohje sa më të kualifikuar më trashëgiminë artistike të epokave kulturore, si kyç për të shpjeguar shpirtin historiko-social dhe thelbin humanitar të artit botëror sipas periudhave dhe epokave të kulturës, po aq dhe madhësinë demokratikë në pasurimin shpirtëror të njeriut nëpërmjet artit me vlera të qëndrueshme. - Të dijë të shijojë e të vlerësojë artin e madh, të krijuar mbi vlera të mëdha etike, religjioze e utopike; të mësojë mekanizmin e progresit të frymores mbi tendencat materialiste në shpjegimin vulgar e utilitarist të realitetit. - dhe, së këndejmi, të dijë të ndërtojë marrëdhënie sa më efektive komunikimi vlerat estetike që kanë për bazë simbolet dhe simbolikën e përvojës shpirtërore në kapërcimin e krizës individuale e shoqërore. 				
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Njohje me konceptin e kulturës, përkufizimet rreth saj, panoramë e gjerë e lëndës, arsyet pse e studiojmë lëndën dhe si mund ta shfrytëzojmë në jetën profesionale e personale.						

2	Epoka parahistorike deri në antikitet (24.000 p.K. – 0): Si lindi njerëzimi, si u zhvilluan vendbanimet e qytetërimet e para; filozofia budiste dhe shkolla e Konfucit, luftërat perse dhe demokracia athinase; rrethanat historike dhe arti pamor në Austri, Spanjë, Francë, Turqi, Mesopotami, Egjipt, Azi, Kinë, Siri e Greqi e lashtë; poema epike e Mesopotamisë dhe ligjet e saj; poemat epike të nënkontinentit indian; poezia epike e Greqisë së Lashtë; teatri antik grek;
3	Epoka parahistorike deri në antikitet (0 -500): Pushtimet e Aleksandrit të Maqedonisë dhe ndikimi në kulturat e vendeve të pushtuara; perandori i parë kinez dhe trashëgimia e tij; qytetërimi mezoamerikan; feja monotesite e judenjve; krishterimi dhe zgjerimi i tij, zgjerimi i filozofisë budiste; arti pamor nga Greqia, Kina, Roma, India, Mezoamerika, Siria, Etiopia, Bizanti, fillesat e artit kristian; poema epike romake.
4	Mesjeta (500 -1000): Hapja e krishterimit; perandoria e Karlit të Madh; sulmet vikinge; gjurmët e qytetërimeve të indianëve të Amerikës; Kina e bashkuar; lindja e perandorisë islamike; qytetërimi islamik' fillesat e shkrimit të muzikës; arti pamor bizantin, anglez, francez, kelt, gjermanik, arti islamik; eposi francez, poema epike angleze, poezia kineze; romani kinez; përrallat perso-arabe
5	Mesjeta (rreth 1000 - 1500): Lufta mes pushtetit perandorak dhe fetar; lindja e universiteteve, kushtet e Magna Carta dhe trashëgimia e saj; Epoka e vogël e akullnajave; qytetërimet acteke e maja dhe kultura e arti i tyre; Kina nën sundimin mongol; arti islam i Malit dhe arti budist; arkitektura gotike në Francë; arti pamor italian, kinez, indian, kmer, i Ishujve të Paqësorit; muzika fetare gjermane, franceze dhe kompozitorët e parë; muzika popullore dhe e oborrit; sagat nordike; letërsia italiane, angleze, kineze,
6	Rilindja dhe manierizmi (1500 - 1600) Ngritja dhe shkëlqimi i perandorisë otomane; dinastia Mugal; zbulimet e mëdha dhe ndikimi i tyre; shkëmbimi kolumbian dhe dinamikat fetare në botë; kushtet e lindjes së Rilindjes në Itali, fillesat e Rilindjes italiane, figurat kryesore; kalimi drejt manierizmit; shpikja e shtypshkronjës; aplikimi i shkencës në artin e Rilindjes; arti pamor islam indiano-pers, meksikan, nigerian, letërsia portugeze; italiane.
7	Rilindja dhe manierizmi (1500 - 1600): Rilindja e Evropës Veriore; çarja e madhe e Luterit, ndikimi i filozofisë së tij; kundër-reformizmi; ndikimi i shtypit në muzikë; arti pamor gjerman, spanjoll, flamand, holandez; letërsia franceze, angleze, gjermane; muzika laike angleze; muzika fetare franceze, angleze, italiane, spanjolle
8	Ese për mbylljen e gjysmës së parë të lëndës
9	Nga baroku te neoklasikja (1600 - 1700): Fillesat e kapitalizmit në Holandë; sundimi i shogunatit në Japoni; zhvillimi i shkencës në Angli; absolutizmi francez; arti pamor flamand, holandez, japonez, anglez, francez, spanjoll, italian; teatri japonez, anglez, francez; letërsia angleze, franceze, spanjolle; veglat muzikore dhe ndikimi i tyre në muzikë, lindja e operës; muzika angleze, franceze, italiane
10	Nga baroku te neoklasikja (1700 - 1800): Dyndja drejt Australisë e Zelandës së Re; Luftërat shtatëvjeçare; pavarësia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës; iluminizmi; teoritë ekonomike të kapitalizmit; fillesat e industrializimit; Dita e Bastijes; ngritja e perandorisë ruse; letërsia franceze, angleze, gjermane, japoneze; tiparet e Sturm und Drang; arti pamor anglez, francez, italian, gjerman; muzika klasike angleze, franceze, italiane, gjermane, austriake, çeke; muzika gjermane e tryezës; fillesat e baletit francez; teatri japonez
11	Nga romantizmi, te realizmi e simbolizmi (1800 - 1900): Revolucioni industrial; tiparet e qytetërimeve të reja; kërkesat për më shumë të drejta; polarizimi ekonomik; prodhimi masiv; arkitektura si tregues i zhvillimit; zbulimet shkencore; revolucioni industrial në Azi, Afrikë e Indi, luftërat e Napoleonit, lindja e nacionalizmit, zanafilla e dy rrymave antagonistike politike në botë; zëvendësimi i ideve iluministe me kultin e individit; demokratizimi i letërsisë, teatrit, muzikës; përhapja e shpejtë e ideve dhe përqaftimi i rrymave në mbarë Evropën; romani historik, fantastiko-shkencor; letërsia romantike, gotike, feministe; kalimi nga romantizmi te realizmi; realizmi psikologjik; letërsia për fëmijë; lindja e simbolizmit.
12	Nga romantizmi, te realizmi e simbolizmi (1800 - 1900): muzika klasike romantike, rezistenca ndaj romantizmit në muzikë; poemat simfonike; variacione mbi romantizmin; ringjallja e korales; romantizmi në opera; elementet folklorikë; pasojat e luftërave mbi artin pamor; romantizmi në pikturë; sfida ndaj institucioneve të artit në Francë; lindja e fotografisë dhe ndikimi i saj në artet pamore; përqaftimi i artit aziatik nga Evropa; simbolizmi në pikturë; fillimet e eksperimentimit me ngjyrën, formën, perceptimin; ngjitja e balerines në skenë; rikthimi i balerinit mashkull; krijimi i tipareve klasike të baletit: veshjet, puante, çifti i koordinuar; lulëzimi i baletit rus; teatri i melodramës romantike; zanafillat e rolit të regjisorit; realizmi në teatër, lindja e dramës si zhanër; teatri natyralist; ngritja e shkollës ruse të teatrit; hedhja e bazave të teatrit profesionist.

13	Epoka moderne (1900 - 2000): Përparimi i shkencës dhe i revolucionit industrial; Depresioni i Madh; teoritë e psikologjisë; forcimi i teorive të majta e të djathta në botë; luftërat botërore; shkenca shkatërruese; ndarja e botës në dy kampe të mëdha, lufta drejt hapësirës; revolucionet e mëdha shoqërore e kulturore; rënia e bllokut komunist; një valë e re nacionalizmi; teknologjia pushton botën; multikulturalizmi; modernizmi; romani vetjak; përroi i ndërgjegjes; brezi i humbur; letërsia policeske; ekzistencializmi; romani distopik, realizmi magjik; beat generation; postmodernizmi
14	Epoka moderne (1900 - 2000): artet pamore: modernizmi, art nouveau, impresionizmi, kubizmi, fovizmi, ekspresionizmi gjerman, abstraksionizmi, dadaizmi, surrealizmi, pop-art, minimalizmi, ekspresionizmi abstrakt, instalacioni; në muzikë: impresionizmi, ekspresionizmi, atonalizmi; serializmi, neoklasicizmi, minimalizmi, tendencat ndër-kulturore; baleti sovjetik dhe diktatura; rigjallërimi i baletit; rikthimi i yllit-balerin; forma të reja në baletin ndërkombëtar, ekspresionizmi thyen konvencionet dhe i jep përparësi ndjenjës; ekspresionizmi në teatër; futurizmi në Itali; regjisorët e mëdhenj rusë, futurizmi-supremacizmi rus, teatri i agjit-propagandës, teatri epik, teatri i fakteve, absurdi, teatri i mizorisë, teatri i varfër, lindja dhe zhvillimi i kinematografisë
15	Diskutim mbi dijet e marra dhe rifreskim i koncepteve kryesore
16	Provim Final
	Parakushtet
	Literatura
	<ul style="list-style-type: none"> • 1. Grant, R. G. (2016). The history book. New York: DK Publishing. • 2. Bugler, C., Kramer, A., Weeks, M., Whatley, M., & Zaczek, I. (2017). The art book. London: Dorling Kindersley. • 3. Gilbert, R. (2016). The literature book. London: DK. • 4. Chilingirian, L. (2018). The classical music book. NY, NY: DK. • 5. Durante, V. (2018). Ballet: the definitive illustrated story. London: DK. • 6. Collins, M., Black, A., Cussans, T., Farndon, J., & Parker, P. (2017). Remarkable books: the worlds most beautiful and historic works. NY, NY: DK Publishing. • 7. Pavis, P. (1998). Dictionary of the theatre: terms, concepts, and analysis. Toronto: University of Toronto Press • 8. Leigh, D., Baxter, L., Farndon, J., Grant, K., & Wise, D. (2016). The movie book. NY, NY: DK Publishing
	Referenca të tjera
	<ul style="list-style-type: none"> • 1. Countries and Their Cultures by Melvin Ember, Carol R. Ember Vol. 1-4 • 2. DK Publishing - Great Paintings. The World's Masterpieces Explored and Explained-Dorling Kindersley (2011) • 3. The Shakespeare Book (Big Ideas Simply Explained) (2016) • 4. (Palgrave Studies in the History of Subcultures and Popular Music) Keith Gildart, Anna Gough-Yates, Sian Lincoln, Bill Osgerby, Lucy Robinson, John Street, Peter Webb, Matthew Worley (eds.) - Youth Culture (2017) • 5. DK - Art That Changed the World- (2013) • 6. Igor Davidenko, Yaroslav Kesler - Book of Civilization (EkoPress-2000) • 7. Palmira J. Brummett, Robert R. Edgar, Neil J. Hackett, George F. Jewsbury, Barbara S. Molony - Civilization Past & Present, Volume A (MyHistoryLab Series) -Longman (2006) • 8. Palmira Brummett, Robert Edgar, Neil J. Hackett, Barbara Molony - Civilization Past & Present_ Volume B -Longman Pearson (2006) • 9. Robert Edgar, Barbara Molony, Neil J. Hackett, Palmira Brummett, George F. Jewsbury - Civilization Past & Present, Volume C -Pearson Education (2006) • 10. Samuel Gregg - Reason, Faith, and the Struggle for Western Civilization-Gateway Editions (25 Jun 2019) • 11. Ted Gioia - Music_ A Subversive History-Basic Books (2019) • 12. Mustafa Kayyali_ Will Durant - The Story of Civilization (2019) • 13. DK Publishing - Modern history in pictures _ a visual guide to the events that shaped our world-DK Publishing (2012) • 14. DK Publishing, Smithsonian Institution - Timelines of History_ The Ultimate Visual Guide To The Events That Shaped The World-DK Publishing (2011)
	Punë laborator
	Përdorimi i komp.
	Të tjera
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	

1	Të njihet studenti me rregullat themelore të artit të të shkruarit
2	Studenti duhet të kryejë punime me nivel të lartë shkencor (ese, detyra kursi, punim diploma)
3	Të analizojë në kontekstin e prodhimit të tij një vepër/objekt artistik a kulturor
4	Të jetë i aftë të dallojë tiparet kryesore të rrymave madhore kulturore dhe të epokave e rrethanave që i prodhuan ato

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	0	0
Kuize	0	0
Projekte	0	0
Projekte semestrare	1	40
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	1	10
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		50
Total		100

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	1	0	0
Gjysmë finale	0	10	0
Provimi final	1	20	20
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			140
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5,6
ECTS			6